**Republika e Kosovës**
**Republic of Kosovo - Republika Kosova**
*Qeveria- Government -Vlada*

---

# PROJEKTLIGJI PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS PËR HEQJEN E KËRKESËS PËR LEGALIZIM TË DOKUMENTEVE ZYRTARE TË HUAJA (5 TETOR 1961)[1]

# DRAFT LAW ON THE RATIFICATION OF THE CONVENTION ABOLISHING THE REQUIREMENT OF LEGALISATION FOR FOREIGN PUBLIC DOCUMENTS (5 OCTOBER 1961)[2]

# NACRT ZAKONA ZA RATIFIKACIJU KONVENCIJE O UKIDANJU POTREBE ZA LEGALIZACIJU STRANIH JAVNIH ISPRAVE (5 OKTOBAR 1961)[3]

---

[1] Projektligji për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961) është miratuar në mbledhjen e 79-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimi Nr. 02/79, datë: 15.03.2016.
[2] Draft Law on the ratification of the Convention abolishing the requirement of legalisation for foreign public documents (5 october 1961), was approved on 79th meeting of the Government of the Republic of Kosovo, with decision No. 02/79, date: 15.03.2016.
[3] Nacrt zakona za ratifikaciju Konvencije o ukidanju potrebe za legalizaciju stranih javnih isprave (5 Oktobar 1961), usvojen je na 79 sednicu Vlade Kosova, odlukom br. 02/79, datum 15.03.2016

| | | |
|---|---|---|
| Kuvendi i Republikës së Kosovës, | The Assembly of the Republic of Kosovo, | Skupština Republike Kosovo, |
| Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) dhe (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, | Pursuant to Articles 18 and 65 (1) and (4) of the Constitution of the Republic of Kosovo, | Na osnovu članova 18 i 65 (1) i (4) Ustava Republike Kosovo, |
| Miraton: | Approves: | Usvaja: |
| **LIGJIN PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS PËR HEQJEN E KËRKESËS PËR LEGALIZIM TË DOKUMENTEVE ZYRTARE TË HUAJA (5 TETOR 1961)** | **LAW ON THE RATIFICATION OF THE CONVENTION ABOLISHING THE REQUIREMENT OF LEGALISATION FOR FOREIGN PUBLIC DOCUMENTS (5 OCTOBER 1961)** | **ZAKONA ZA RATIFIKACIJU KONVENCIJE O UKIDANJU POTREBE ZA LEGALIZACIJU STRANIH JAVNIH ISPRAVE (5 OKTOBAR 1961)** |
| **Neni 1**<br>**Qëllimi** | **Article 1**<br>**Purpose** | **Član 1**<br>**Cilj** |
| Me anë të këtij ligji ratifikohet Konventa për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja, e datës 5 tetor 1961 ( teksti i bashkëngjitur ne Shtojcën I të këtij ligji) | Through this law, the Convention Abolishing the Requirement for Legalization for Foreign Public Documents of 5 October 1961 is ratified ( text of Convention attached to this Law as Annex I) | Kroz ovaj zakon se ratifikuje Konvencija o ukidanje zahteva za legalizaciju stranih javnih isprava, od dana 5 oktobar 1961 godine( tekst Konvencije u prilogu Aneks I ovog zakona) . |
| **Neni 2**<br>**Fushëveprimi** | **Article 2**<br>**Scope** | **Član 2**<br>**Delokrug** |
| Fushëveprimi i këtij ligji është ratifikimi i Konventës për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja, e datës 6 tetor 1961, e miratuar si nismë nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin nr. 07/51, të datës 25 shtator 2015, | The scope of this law is Ratification of the Convention Abolishing the Requirement of Legalization for Foreign Public Documents of 5 October 1961, adopted as an initiative by the Government of the Republic of Kosovo by the decision no. 07/51, dated 25th September | Delokrug ovog zakona je ratifikacija ove Konvente o ukidanje zahteva za legalizaciju stranih javnih isprava od dana 6. oktobar 1061, usvojena kao inicijativa od strane Vlade Republike Kosovo odlukom br. 07/51, od dana 25. septembar 2015. godine, kao i |

| | | |
|---|---|---|
| si dhe me depozitimin e instrumentit të aderimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Holandës më datë 6 nëntor 2015. | 2015, and by the deposition of the instrument of accession with the Ministry of Foreign Affairs of the Kingdom of the Netherlands on 6th November 2015. | deponovanjem instrumenta za pristupanje u Ministarstvu Inostranih Poslova Kraljevine Holandije, 6. novembra 2015. godine. |
| **Neni 3**<br>**Autoritet kompetente**<br><br>Në përputhje me nenin 6 të Konventës, autoritetet kompetente për përmbushjen e detyrave të kësaj Konvente janë Departamenti për Çështje Konsullore-MPJ dhe Agjencioni i Regjistrimit Civil-MPB | **Article 3**<br>**Competent Authority**<br><br>In accordance with Article 6 of the Convention, the competent authorities to fulfill the tasks of this Convention are the Department for Consular Issues – MFA, and Civil Registration Agency – MIA. | **Član 3**<br>**Nadležni organi**<br><br>U skladu sa članom 6. Konvencije, nadležni organi za ispunjenje obaveza ove Konvencije su Odeljenje za konzularna pitanja – MIP i Agencija za civilni registar - MUP |
| **Neni 4**<br>**Zbatimi i Ligjit**<br><br>Për zbatimin e këtij ligji sipas propozimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, Qeveria do të miratoi aktet nënligjore me qëllim të zbatitmit të dispozitave përkatëse të Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja e dates 5 tetor 1961. | **Article 4**<br>**Implementation of the Law**<br><br>For implementation of this law, upon the proposal by the Ministry of Internal Affairs and the Ministry of Foreign Affairs, the Government shall approve sub-legal acts for the purpose of implementation of the dispositions of the Convention Abolishing the Requirement of Legalization for Foreign Public Documents of 5 October 1961. | **Član 4**<br>**Sprovođenje Zakona**<br><br>Za sprovođenje ovog Zakona u skladu sa predlogom Ministarstva Unutrašnjih Poslova i Ministarstva Inostranih Poslova, Vlada će usvojiti podzakonske akte svrhom sprovodjenja relevantnih odredbi Konvencije o ukidanju potrebe legalizacije stranih službenih isprava od 5 oktobra 1961. |
| **Neni 5**<br>**Përjashtimi nga fusha e zbatimit**<br><br>Ky ligj nuk rregullon procedurat e legalizimit të dokumenteve të huaja respektivisht për shtetet që shprehin kundërshtimin për | **Article 5**<br>**Exclusion from the Scope of Implementation**<br><br>This law does not regulate the procedure of legalization of foreign documents, respectively for the states that express | **Član 5**<br>**Isključenje iz oblasti Sprovođenja**<br><br>Ovaj Zakon ne reguliše procedure legalizacije stranih dokumenata odnosno za države koje izražavaju rezervisanje za pristupanje |

| | | |
|---|---|---|
| aderimin e Republikës së Kosovës në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja te datës 5 tetor 1961. | objection on the accession of the Republic of Kosovo to the Convention Abolishing the Requirement of Legalization for Foreign Public Documents of 5 October 1961. | Republike Kosovo u Konvenciji o ukidanje zahteva za legalizaciju stranih javnih isprava od 5 oktobra 1961. |
| **Neni 6**<br>**Dispozitat Kalimtare** | **Article 6**<br>**Transitional Provisions** | **Član 6**<br>**Prelazne odredbe** |
| Aktet nënligjore që janë miratuar para se të hyjë në fuqi ky ligj vlejnë deri në atë masë që nuk janë në kundërshtim me këtë ligj. | Sub-legal acts that are approved prior to the entry into force of this law are valid up to that extent that is not inconsistent with this law. | Podzakonski akti, koji su usvojeni pre nego da stupi na snagu ovaj Zakon, važe do te mere da nisu u suprotnosti sa ovim Zakonom. |
| **Neni 7**<br>**Hyrja në Fuqi** | **Article 7**<br>**Entry into force** | **Član 7**<br>**Stupanje na snagu** |
| Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. | This Law shall enter into force fifteen (15) days from its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo. | Ovaj zakon stupa na snagu petnaest (15) dana od dana objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo. |
| Kadri Veseli<br>____________________<br>Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovë | Kadri Veseli<br>____________________<br>The President of the Assembly of the Republic of Kosovo | Kadri Veseli<br>____________________<br>Predsednik Skupštine Republike Kosovo |

| Shtojca I | Annex I | Aneks I |
|---|---|---|
| **KONVENTA PËR HEQJEN E KËRKESËS PËR LEGALIZIM TË DOKUMENTEVE ZYRTARE TË HUAJA (5 TETOR 1961)** | **CONVENTION ABOLISHING THE REQUIREMENT OF LEGALISATION FOR FOREIGN PUBLIC DOCUMENTS (5 OCTOBER 1961)** | **KONVENCIJA O UKIDANJU POTREBE ZA LEGALIZACIJE STRANIH JAVNIH ISPRAVA (5 OKTOBRA 1961)** |
| Shtetet Palë në këtë Konventë,<br>Me dëshirën për të hequr kërkesën për legalizim diplomatik dhe konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja, vendosën të hartojnë këtë Konventë duke rënë dakord si më poshtë: | The States signatory to the present Convention,<br>Desiring to abolish the requirement of diplomatic or consular legalisation for foreign public documents, have resolved to conclude a Convention to this effect and have agreed upon the following provisions: | Države potpisnice ove Konvencije,<br>Želeći da ukinu zahtev za diplomatsku ili konzularnu legalizaciju stranih javnih dokumenata, odlučile su da zaključe Konvenciju u tom smislu i da se dogovore o sledećim odredbama: |
| **Neni 1** | **Article 1** | **Član 1** |
| Kjo Konventë zbatohet për dokumentet zyrtare që ekzekutohen në territorin e një Shteti Palë dhe lëshohen (prodhohen) në territorin e një Shteti tjetër Palë.<br>Në kuptim të kësaj Konvente konsiderohen zyrtare: | The present Convention shall apply to public documents which have been executed in the territory of one Contracting State and which have to be produced in the territory of another Contracting State.<br>For the purposes of the present Convention, the following are deemed to be public documents: | Ova se Konvencija primjenjuje na javne isprave izdane na području jedne države ugovornice i koje se trebaju predočiti na području druge države ugovornice.<br>Stranim javnim ispravama, u smislu ove konvencije, smatraju se: |
| a) Dokumentet e lëshuara nga një autoritet ose funksionar i lidhur me gjyqësorin e shtetit, përfshi edhe dokumentet e lëshuara nga prokuroritë, sekretaritë e gjykatave dhe zyrat përmbarimore; | a) Documents emanating from an authority or an official connected with the courts or tribunals of the State, including those emanating from a public prosecutor, a clerk of a court or a process-server ("*huissier de justice*"); | a) Isprave koje je izdao sud ili službena osoba vezana uz državne sudove ili javnog tužioca, voditelj sudske pisarnice ili sudski izvršitelj ("huissier de justice"); |
| b) Dokumentet administrative; | b) Administrative documents; | b) Upravne isprave; |

| | | |
|---|---|---|
| c) Aktet noteriale; | c) Notarial acts; | c) Javnobilježničke isprave; |
| d) Vërtetimet zyrtare, vendosur mbi një dokument dhe firmosur nga një person në cilësinë e tij si individ, që dëshmojnë regjistrimin e këtij dokumenti ose ekzistencën e tij në një datë të caktuar, si edhe vërtetimin zyrtar e noterial të vërtetësisë së firmave. | d) Official certificates which are placed on documents signed by persons in their private capacity, such as official certificates recording the registration of a document or the fact that it was in existence on a certain date and official and notarial authentications of signatures. | d) Službena uvjerenja stavljena na privatne isprave, kao što su navodi o registraciji, ovjera točnosti datuma, ovjera potpisa. |
| Kjo Konventë nuk zbatohet: | However, the present Convention shall not apply: | Međutim, ova konvencija se ne primjenjuje: |
| a) Për dokumentet e ekzekutuara nga agjentë diplomatikë ose konsullorë; | a) To documents executed by diplomatic or consular agents; | a) Na isprave koje su izdali diplomatski ili konzularni predstavnici; |
| b) Për dokumentet administrative që lidhen drejtpërdrejt me veprime tregtare ose doganore. | b) To administrative documents dealing directly with commercial or customs operations. | b) Na isprave upravnih tijela koje se neposredno odnose na trgovinsko ili carinsko poslovanje. |
| **Neni 2** | **Article 2** | **Član 2** |
| Çdo Shtet Palë përjashton nga legalizimi dokumentet e lëshuara në territorin e tij mbi të cilat zbatohet kjo Konventë. Në kuptim të kësaj Konvente, legalizimi nënkupton vetëm aktin e formalitetit, me anë të të cilit agjentët diplomatikë ose konsullorë të shtetit, në territorin e të cilit lëshohet dokumenti, vërtetojnë autenticitetin e firmës, cilësinë me të cilën ka vepruar personi që ka firmosur dokumentin dhe, nëse është rasti, identitetin e vulës dhe pullës që bart. | Each Contracting State shall exempt from legalisation documents to which the present Convention applies and which have to be produced in its territory. For the purposes of the present Convention, legalisation means only the formality by which the diplomatic or consular agents of the country in which the document has to be produced certify the authenticity of the signature, the capacity in which the person signing the document has acted and, where appropriate, the identity of the seal or stamp which it bears. | Svaka država ugovornica oslobađa od legalizacije one isprave na koje se primjenjuje ova konvencija i koje se trebaju predočiti na njenom području. U smislu ove konvencije legalizacija se smatra formalnošću kojom diplomatski ili konzularni predstavnik one zemlje na čijem području isprava treba biti predočena, potvrđuje vjerodostojnost potpisa, svojstvo u kojem je potpisnik te isprave djelovao i po potrebi, vjerodostojnost pečata ili žiga što ga sadrži. |

| Neni 3 | Article 3 | Član 3 |
|---|---|---|
| Me qëllim që të vërtetohet autenticiteti i firmës, cilësia në të cilën ka vepruar personi që firmos dokumentin dhe, nëse është rasti, identiteti i vulës apo pullës që ai bart, formaliteti i vetëm që mund të kërkohet është paraqitja e një certifikate, të përshkruar në nenin 4, lëshuar nga autoriteti kompetent i shtetit që nxjerr dokumentin. | The only formality that may be required in order to certify the authenticity of the signature, the capacity in which the person signing the document has acted and, where appropriate, the identity of the seal or stamp which it bears, is the addition of the certificate described in Article 4, issued by the competent authority of the State from which the document emanates. | Jedina formalnost koja se može zahtijevati za potvrdu vjerodostojnosti potpisa, svojstva u kojem je potpisnik isprave postupio i, po potrebi, vjerodostojnosti pečata ili žiga koju ta isprava sadrži, jest sastavljanje potvrde koju utvrđuje članak 4. što je daju nadležna tijela države u kojoj je isprava izdana. |
| Megjithatë, formaliteti i përmendur në paragrafin e mësipërm nuk mund të kërkohet në rastin kur ligjet, rregulloret dhe praktika në fuqi në shtetin në të cilin lëshohet dokumenti ose një marrëveshje midis dy a më shumë Shteteve Palë e shmang, e thjeshton ose e përjashton dokumentin nga legalizimi. | However, the formality mentioned in the preceding paragraph cannot be required when either the laws, regulations, or practice in force in the State where the document is produced or an agreement between two or more Contracting States have abolished or simplified it, or exempt the document itself from legalisation. | Međutim, ni formalnost navedena u prethodnom stavku ne može se zahtijevati ako je ona zakonima, propisima ili običajima koji su na snazi u državi gdje se isprava predočuje ili sporazumom između dve ili više država ugovornica, ukinuta, pojednostavljena ili je takva isprava oslobođena legalizacije. |
| **Neni 4** | **Article 4** | **Član 4** |
| Certifikata e përmendur në nenin 3 paragrafi i parë vendoset për së gjati në një qoshe të dokumentit, sipas modelit bashkëngjitur kësaj Konvente.<br>Megjithëse ajo mund të hartohet në gjuhën zyrtare të autoritetit që e lëshon dhe në një gjuhë të dytë, titulli, certifikata, duhet të jenë në gjuhën frënge “Apostille” (Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961). | The certificate referred to in the first paragraph of Article 3 shall be placed on the document itself or on an "*allonge*"; it shall be in the form of the model annexed to the present Convention.<br>It may, however, be drawn up in the official language of the authority which issues it. The standard terms appearing therein may be in a second language also. The title "Apostille (Convention de La Haye du 5 Octobre 1961)" shall be in the French language. | Potvrda predviđena u članku 3, stavak 1, stavlja se na samu ispravu ili na njen dodatak; ona treba biti prema obrascu koji se prilaže ovoj konvenciji.<br>Međutim ta isprava može biti sastavljena na službenom jeziku tijela koje ju je izdalo. Tiskani njezini dijelovi mogu biti također na nekom drugom jeziku. No njen naslov, "Apostille (Convention de La Haye du 5 octobre1961)" treba biti na francuskom jeziku. |

| Neni 5 | Article 5 | Član 5 |
|---|---|---|
| Certifikata lëshohet me kërkesë të personit që ka firmosur dokumentin ose të çdo personi tjetër. Nëse plotësohet saktësisht, ajo vërteton autenticitetin e firmës, cilësinë në të cilën ka vepruar personi që e ka firmosur dhe, nëse është rasti, identitetin e vulës ose pullës që ky dokument bart.<br>Firma, vula dhe pulla në certifikatë përjashtohen nga çdo lloj vërtetimi i mëtejshëm. | The certificate shall be issued at the request of the person who has signed the document or of any bearer. When properly filled in, it will certify the authenticity of the signature, the capacity in which the person signing the document has acted and, where appropriate, the identity of the seal or stamp which the document bears. The signature, seal and stamp on the certificate are exempt from all certification. | Potvrda se izdaje na zahtjev potpisnika ili svakog drugog imaoca isprave. Propisno ispunjena, ona potvrđuje vjerodostojnost potpisa, svojstvo u koje je potpisnik isprave postupio i, po potrebi, vjerodostojnost pečata ili žiga što ga sadrži.<br>Potpis, pečat ili žig na potvrdi izuzeti su od ovjere. |
| **Neni 6** | **Article 6** | **Član 6** |
| Mbështetur në paragrafin e parë të nenit 3, çdo Shtet Palë përcakton autoritetin kompetent për nxjerrjen e certifikatës në përputhje me funksionin zyrtar të tij. | Each Contracting State shall designate by reference to their official function, the authorities who are competent to issue the certificate referred to in the first paragraph of Article 3. | Svaka država ugovornica određuje tijela koja su nadležna za izdavanje potvrda na osnovi članka 3, stavak 1. |
| Në momentin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të aderimit ose të deklaratës së zgjerimit, Shteti Palë njofton Ministrinë e Punëve të Jashtme të Hollandës për caktimin e autoritetit kompetent për nxjerrjen e certifikatës, si edhe për ndryshimet e mundshme të autoritetit kompetent në të ardhmen. | It shall give notice of such designation to the Ministry of Foreign Affairs of the Netherlands at the time it deposits its instrument of ratification or of accession or its declaration of extension. It shall also give notice of any change in the designated authorities. | O tome izvještava Ministarstvo vanjskih poslova Nizozemske prilikom polaganja svog instrumenta o ratifikaciji ili pristupanja ili pri izjavi o proširenju konvencije. Ona ga izvještava i o svakoj promjeni nadležnog tijela. |
| **Neni 7** | **Article 7** | **Član 7** |
| Autoriteti kompetent, në zbatim të nenit 6, mban një regjistër në të cilin regjistrohen | Each of the authorities designated in accordance with Article 6 shall keep a register | Svako tijelo određeno u skladu sa člankom 6, treba voditi registar ili kartoteku u kojima se |

| | | |
|---|---|---|
| certifikatat e lëshuara, duke specifikuar:<br><br>a) Numrin dhe datën e certifikatës;<br><br>b) Emrin e personit që firmos dokumentin zyrtar dhe cilësinë në të cilën ka vepruar ose, në rastet e dokumenteve të pafirmosura, emrin e autoritetit që ka vënë vulën ose pullën.<br><br>Me kërkesë të personit të interesuar, autoriteti që ka lëshuar certifikatën vërteton nëse të dhënat në certifikatë korrespondojnë me të dhënat e mbajtura në regjistër | or card index in which it shall record the certificates issued, specifying:<br><br>a) The number and date of the certificate,<br><br>b) The name of the person signing the public document and the capacity in which he has acted, or in the case of unsigned documents, the name of the authority which has affixed the seal or stamp.<br><br>At the request of any interested person, the authority which has issued the certificate shall verify whether the particulars in the certificate correspond with those in the register or card index. | unose izdate potvrde, s navođenjem:<br><br>a) Poslovnog broja i datuma potvrde;<br><br>b) Ime potpisnika javne isprave i svojstvo u kojem je on djelovao, a za isprave bez potpisa, tijelo koje je stavilo pečat ili žig.<br><br>Na zahtjev interesirane osobe, tijelo koje je izdalo potvrdu treba utvrditi da li se podaci u potvrdi slažu s podacima u registru ili kartoteci. |
| **Neni 8**<br><br>Nëse midis dy ose më shumë Shteteve Palë ekziston një marrëveshje, traktat ose konventë, që përmban dispozita që lidhen me vërtetimin e firmës, vulës ose pullës për disa formalitete të caktuara, dispozitat e kësaj Konvente kanë përparësi përsa u takon atyre dispozitave që sanksionojnë formalitete më strikte, sesa ato të parashikuara në nenet 3 dhe 4. | **Article 8**<br><br>When a treaty, convention or agreement between two or more Contracting States contains provisions which subject the certification of a signature, seal or stamp to certain formalities, the present Convention will only override such provisions if those formalities are more rigorous than the formality referred to in Articles 3 and 4. | **Članak 8**<br><br>Ako između dve ili više država ugovornica postoji međunarodni ugovor, konvencija ili sporazum po kojima je ovjera potpisa, pečata ili žiga podvrgnuta određenim formalnostima, ova konvencija ukida samo one njihove odredbe što propisuju strože formalnosti od onih propisanih člancima 3. i 4. |
| **Neni 9**<br><br>Çdo Shtet Palë merr masat e nevojshme për të shmangur legalizimin e dokumenteve nga agjentët e tij diplomatikë dhe konsullorë në | **Article 9**<br><br>Each Contracting State shall take the necessary steps to prevent the performance of legalisations by its diplomatic or consular | **Član 9**<br><br>Svaka država ugovornica poduzima potebne mjere kako bi se izbjeglo da njeni diplomatski ili konzularni predstavnici vrše legalizacije u |

| | | |
|---|---|---|
| rastet kur kjo Konventë parashikon përjashtimin. | agents in cases where the present Convention provides for exemption. | slučajevima koji su po ovoj konvenciji oslobođeni od takvog postupka. |
| **Neni 10** | **Article 10** | **Član 10** |
| Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim për shtetet e përfaqësuara në sesionin e nëntë të Konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private si dhe për Islandën, Irlandën, Lichtenstein dhe Turqinë. | The present Convention shall be open for signature by the States represented at the Ninth Session of the Hague Conference on Private International Law and Iceland, Ireland, Liechtenstein and Turkey. | Ova Konvencija biće otvorena za potpisivanje od strane država predstavljenih na devetoj sednici Haške konferencije za međunarodno privatno pravo i Islandu, Irski, Lihtenštajnu i Turskoj. |
| Pas ratifikimit instrumentet përkatës depozitohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Hollandës. | It shall be ratified, and the instruments of ratification shall be deposited with the Ministry of Foreign Affairs of the Netherlands. | Biće ratifikovana, a ratifikacioni instrumenti biće deponovani u Ministarstvu inostranih poslova Holandije. |
| **Neni 11** | **Article 11** | **Član 11** |
| Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 10.<br>Konventa hyn në fuqi për çdo Shtet Palë që e ratifikon në një datë të mëvonshme, në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumenteve përkatëse të ratifikimit. | The present Convention shall enter into force on the sixtieth day after the deposit of the third instrument of ratification referred to in the second paragraph of Article 10. The Convention shall enter into force for each signatory State which ratifies subsequently on the sixtieth day after the deposit of its instrument of ratification. | Ova konvencija stupa na snagu šezdeseti dan nakon deponovanja trećeg instrumenta o ratifikaciji iz drugog stava člana 10.<br>Konvencija stupa na snagu za svaku državu potpisnicu koja će je kasnije ratifikovati šezdesetog dana nakon deponovanja njenog ratifikacijskog instrumenta. |
| **Neni 12** | **Article 12** | **Član 12** |
| Çdo shtet, që nuk përmendet në nenin 10, mund të aderojë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të saj në përputhje me nenin 11 paragrafi i parë. Instrumenti i aderimit depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të | Any State not referred to in Article 10 may accede to the present Convention after it has entered into force in accordance with the first paragraph of Article 11. The instrument of accession shall be deposited with the Ministry | Svaka država koja nije navedena u članu 10. može pristupiti ovoj Konvenciji nakon njenog stupanja na snagu u skladu sa prvim stavom člana 11. Instrument za pristupanje deponuje se u Ministarstvu inostranih poslova |

| | | |
|---|---|---|
| Jashtme të Hollandës.<br>Ky aderim do të ketë efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet midis shtetit aderues dhe Shteteve Palë, të cilat nuk kanë paraqitur kundërshtim për këtë aderim brenda gjashtë muajve nga marrja e lajmërimit, parashikuar nga neni 15 pika d. Për çdo kundërshtim duhet të njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës.<br>Konventa hyn në fuqi, ndërmjet shtetit aderues dhe shteteve, të cilat nuk kanë paraqitur kundërshtime për këtë aderim ditën e gjashtëdhjetë pas përfundimit të periudhës 6 - mujore, përmendur në paragrafin më sipër. | of Foreign Affairs of the Netherlands.<br>Such accession shall have effect only as regards the relations between the acceding State and those Contracting States which have not raised an objection to its accession in the six months after the receipt of the notification referred to in sub-paragraph *d)* of Article 15. Any such objection shall be notified to the Ministry of Foreign Affairs of the Netherlands. The Convention shall enter into force as between the acceding State and the States which have raised no objection to its accession on the sixtieth day after the expiry of the period of six months mentioned in the preceding paragraph. | Holandije.<br>Takvo pristupanje ima uticaj samo u pogledu odnosa između pristupne države i onih država potpisnica koje nisu priložile prigovor na njeno pristupanje šest meseci nakon prijema obaveštenja iz podstava d) člana 15. O bilo kom takvom prigovoru obaveštava se Ministarstvo inostranih poslova Holandije.<br>Konvencija stupa na snagu između pristupne države i država koje nisu uložile nikakav prigovor u vezi njenog pristupanja šezdesetog dan po isteku roka od šest meseci navedenog u prethodnom stavu. |
| **Neni 13** | **Article 13** | **Član 13** |
| Në momentin e nënshkrimit, ratifikimit dhe aderimit, çdo shtet deklaron shtrirjen e efekteve të kësaj Konvente, në të gjithë territorin që ai përfaqëson në nivel ndërkombëtar apo në një ose disa prej tyre. Kjo deklaratë bëhet efektive në momentin e hyrjes në fuqi të Konventës në atë shtet.<br>Në vazhdimësi, për çdo shtrirje të kësaj natyre njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës.<br>Nëse deklarata e zgjerimit bëhet nga një shtet, i cili e ka nënshkruar dhe e ka ratifikuar Konventën, kjo Konventë hyn në fuqi për territoret në fjalë në përputhje me dispozitat e nenit 11. Nëse deklarata e zgjerimit bëhet nga një shtet, i cili ka aderuar, kjo Konventë hyn | Any State may, at the time of signature, ratification or accession, declare that the present Convention shall extend to all the territories for the international relations of which it is responsible, or to one or more of them. Such a declaration shall take effect on the date of entry into force of the Convention for the State concerned.<br>At any time thereafter, such extensions shall be notified to the Ministry of Foreign Affairs of the Netherlands.<br>When the declaration of extension is made by a State which has signed and ratified, the Convention shall enter into force for the territories concerned in accordance with Article 11. When the declaration of extension | Svaka država može, u trenutku potpisivanja, ratifikacije ili pristupanja da izjavi da će se ova konvencija proširiti na svim teritorijama međunarodnih odnosa za koje je ona odgovorna ili na jednu ili više njih. Takva izjava stupa na snagu dana kada Konvencija stupa na snagu za dotične države.<br>U svakom trenutku nakon toga, o takvim produžecima, Ministarstvo inostranih poslova Holandije se obaveštava.<br>Kada je deklaracija o produženju sačinjena od strane države koja je potpisala i ratifikovala, Konvencija stupa na snagu za navedene teritorije u skladu sa članom 11. Kada je deklaracija o produženju sačinjena od strane države koja je pristupila, Konvencija stupa na |

| | | |
|---|---|---|
| në fuqi për këto territore në përputhje me dispozitat e nenit 12. | is made by a State which has acceded, the Convention shall enter into force for the territories concerned in accordance with Article 12. | snagu za navedene teritorije koje su u skladu sa članom 12. |
| **Neni 14** | **Article 14** | **Član 14** |
| Kjo Konventë ka një kohëzgjatje 5-vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi, në përputhje me nenin 1 paragrafi i parë, përfshi edhe shtetet që e kanë ratifikuar ose e kanë aderuar në një datë të mëvonshme.<br>Nëse nuk ka denoncime, Konventa rinovohet në mënyrë të heshtur çdo pesë vjet. Çdo denoncim i njoftohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Hollandës të paktën 6 muaj përpara përfundimit të periudhës prej 5 vjetësh.<br>Ajo mund të kufizohet për disa territore në të cilat zbatohet Konventa.<br>Denoncimi ka efekt vetëm për shtetin që e paraqet. Konventa mbetet në fuqi për shtetet e tjera palë. | The present Convention shall remain in force for five years from the date of its entry into force in accordance with the first paragraph of Article 11, even for States which have ratified it or acceded to it subsequently. If there has been no denunciation, the Convention shall be renewed tacitly every five years. Any denunciation shall be notified to the Ministry of Foreign Affairs of the Netherlands at least six months before the end of the five year period. It may be limited to certain of the territories to which the Convention applies. The denunciation will only have effect as regards the State which has notified it. The Convention shall remain in force for the other Contracting States. | Ova Konvencija ostaje na snazi pet godina od dana njenog stupanja na snagu u skladu sa prvim stavom člana 11, čak i za države koje su je kasnije ratifikovale ili pristupile.<br>Da nije bilo osude, Konvencija bi se prećutno obnavljala svakih pet godina.<br>O svakoj osudi obaveštava se Ministarstvo inostranih poslova Holandije najmanje šest meseci pre isteka perioda od pet godina.<br>Može biti ograničena na određene teritorije koje primenjuju Konvencije.<br>Osuda stupa na snagu samo u pogledu država koje su obaveštene o tome. Konvencija ostaje na snazi za ostale države potpisnice. |
| **Neni 15** | **Article 15** | **Član 15** |
| Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës u njofton Shteteve Palë të përmendura në nenin 10, si dhe shteteve që kanë aderuar në përputhje me nenin 12, sa më poshtë: | The Ministry of Foreign Affairs of the Netherlands shall give notice to the States referred to in Article 10, and to the States which have acceded in accordance with Article 12, of the following: | Ministarstvo inostranih poslova Holandije obaveštava države navedene u članu 10, kao i države koje su pristupile u skladu sa članom 12, o sledećem: |
| a) Njoftimin e parashikuar në nenin 6 paragrafi i dytë; | a) The notifications referred to in the second paragraph of Article 6; | a) Obaveštenjima iz drugog stava člana 6; |

| | | |
|---|---|---|
| b) Nënshkrimet dhe ratifikimet e parashikuara në nenin 10; | b) The signatures and ratifications referred to in Article 10; | b) Potpisivanju i ratifikacijama iz člana 10; |
| c) Datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me nenin 11 paragrafi i parë; | c) The date on which the present Convention enters into force in accordance with the first paragraph of Article 11; | c) Datumu stupanja na snagu ove Konvencije u skladu sa prvim stavom člana 11; |
| d) Aderimet dhe kundërshtimet e parashikuara në nenin 12 dhe datën në të cilën ato bëhen efektive; | d) The accessions and objections referred to in Article 12 and the date on which such accessions take effect; | d) Pristupanjima i prigovora iz člana 12 i datuma stupanja takvog pristupanja na snagu; |
| e) zgjerimet e parashikuara në nenin 13 dhe datën në të cilat ato bëhen efektive; | e) The extensions referred to in Article 13 and the date on which they take effect; | e) Produžecima iz člana 13 i datuma kada oni stupaju na snagu; |
| f) denoncimet e parashikuara në nenin 14 paragrafi i tretë. | f) The denunciations referred to in the third paragraph of Article 14. | f) Osudi iz trećeg stava člana 14. |
| Në dëshmi të kësaj, personat e autorizuar posaçërisht nënshkruajnë këtë Konventë në Hagë, më 5 tetor 1961 në dy gjuhë, anglisht dhe frëngjisht, të lidhura në një kopje të vetme, ku teksti frëngjisht ka përparësi në rast divergjencash ndërmjet dy teksteve. Kopja e vetme depozitohet në arkivat e Qeverisë holandeze. Prej së cilës një kopje e vërtetuar i dërgohet nëpërmjet kanaleve diplomatike çdo shteti të përfaqësuar në sesionin e nëntë të konferencës së Hagës mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private, si dhe Islandës, Irlandës, Lichtenshtajnit dhe Turqisë. | In witness whereof the undersigned, being duly authorized thereto, have signed the present Convention.<br>Done at The Hague the 5th October 1961, in French and in English, the French text prevailing in case of divergence between the two texts, in a single copy which shall be deposited in the archives of the Government of the Netherlands, and of which a certified copy shall be sent, through the diplomatic channel, to each of the States represented at the Ninth Session of the Hague Conference on Private International Law and also to Iceland, Ireland, Liechtenstein and Turkey. | U potvrdu čega su dole potpisani, propisno ovlašćeni u tu svrhu, potpisali ovu Konvenciju.<br>Sačinjeno u Hagu 5. oktobra 1961, na francuskom i engleskom jeziku, francuski tekst preovladava u slučaju neslaganja između dva teksta, jedan primerak biće deponovan u arhivi Vlade Holandije, a od kojih overena kopija biće poslata diplomatskim putem svakoj od država predstavljenih na devetoj sednici Haške konferencije za međunarodno privatno pravo, kao i Islandu, Irski, Lihtenštajnu i Turskoj. |